

TABELA E LENDES

1. KONSIDERATA TE PERGJITESHME.....	2
1.1 INDUSTRIA E LETRES NE VEND	2
1.2 AMBALLAZHIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE	2
1.3 MATERIALET QE PERDOREN PER PRODHIMIN E AMBALLAZHEVE	3
1.4 RIKIKLIMI DHE LEGJISLACIONI I PERDORIMIT TE AMBALLAZHEVE....	6
2. ANALIZA E TREGUT TE AMBALLAZHEVE PREJ LETRE	8
2.1 ANALIZA E TREGUT TE MIELLIT	8
2.2 ANALIZA E TREGUT TE HIMEVE	13
2.3 ANALIZA E TREGUT TE SHEQERIT	14
2.4 ANALIZA E TREGUT TE BIMEVE MEDICINALE	15
2.5 ANALIZA E TREGUT TE PLEHRAVE KIMIKE	15
2.6 ANALIZA E TREGUT TE CIMENTOS	16
2.7 AMBALLAZHET E PLUHURAVE TE TJERE NENPORDUKTE TE CIMENTOS	23
2.8 ANALIZA E BURIMEVE TE FURNIZIMIT TE TREGUT ME THASE E QESE LETRES PER PERIUDHEN 2010-2015.....	25
3. ANALIZA E BURIMEVE TE FURNIZIMIT TE TREGUT ME THASE E QESE LETTRE.....	28

1. KONSIDERATA TE PERGJITHESHME

1.1 INDUSTRIJA E LETRES NE VEND

Industria e letres filloi te zhvillohet ne Shqiperi mbas viteve 60. Ne vitin 1965 u ngrit ne Shkoder fabrika e letres se amballazhit per thase cimentoje, se ciles ju shtua me 1972 edhe nje fabrike tjeter e tille. Po ne vitin 1965 u ngrit ne Kavaje fabrika e pare per prodhimin e letres per shtypshkrime, qe perpunon drurin e ahut e te pishes si dhe kashten e grurit. Ne vitin 1966 u vu ne pune ne Lushnje fabrika e letres dhe e kartonit per amballazhe qe perpunon kashten e grurit. Me 1971 dhe 1979 u vune ne shfrytezim ne Tirane dy fabrika te kartonit te valezuar per arka amballazhi, qe perpunojne mbeturinat e letrave dhe leckave te pambukta. Me 1978 u ngrit Fabrika e letres ne Lezhe, me e madhja ne vend, qe prodhonte leter shtypshkrimi e per gazete nga perpunimi i drurit te pishes, bredhit dhe plepit. Me 1983 hyri ne shfrytezim fabrika e letres ne Lac per prodhimin e letrave te holla te amballazhit nga mbetjet teknologjike te drurit te pishes.

Per shfrytezimin racional te lendes se pare te vendit u ngriten linja e reparte te reja me permasa me te vogla si linja e prodhimit te kartonit ne Fabrikat e letres ne Lushnje e Kavaje e te pllakave bituminoze ne Lushnje, si dhe nje linje ne Kavaje e nje Fabrike e vecante ne Lac per prodhimin e lignosulfonateve te kalciumit, hekurit e kromit per nevojat e industries se naftes, asaj mekanike e metalurgjike. Ne fabriken e letres ne Kavaje u ngriten reparte per prodhimin e kartonit fiber per kepuce, letres filtruese e letres ozolite etj.

Ne vitin 1984 u prodhuan 8,500 ton leter shkrimi e shtypi dhe 12,700 ton karton e kartoncine.

1.2 AMBALLAZHIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE

Sot ekziston nje shmellojshmeri amballazhesh te produkteve ushqimore prej qelqi, letre, plastike, druri, metali etj. Vleresimi i ketij problemi, ka cuar ne arritjet e sotme te industrise per prodhimin e amballazheve teper te sofistikuara, higjenike dhe terheqese per konsumatorin. Konkurenca dhe standartet e kerkuara te amballazheve, e bejne teper te veshtire perzgjedhjen e tyre ne perputhje me specifikat e produkteve te ndryshme industriale e ushqimore. Amballazhet duhet te jene lehtesisht te identifikueshem, te manovrueshem, te markueshem e te etiketueshem, te kene volume te pershtateshme perdorimi dhe te jene te paraqitshem, por ajo qe eshte me kryesorja, pajtueshmeria e perberjes se materialit amballazhues me produktin ushqimor perkates (te mos kete nderveprim kimik, deformues dhe qe te migroje aroma apo kimikate te demeshme ne keto produkte).

Llojet e ndryshme te amballazheve ushqimore

Prodhesit e produkteve te ndryshme ushqimore I amballazhojne produktet e tyre per ti mbrojtur ato, per ti tregetuar ne madhesi e permasa te caktuara, per marketing tregetar dhe per te zbatuar rregullat e ligjet lidhur me prodhimin dhe tregetimin e tyre.

1.3 MATERIALET QE PERDOREN PER PRODHIMIN E AMBALLAZHEVE

Materialet e paketimit me te perdorshem per amballazhimin e produkteve ushqimore jane materialet plastike, qelqi, alumini dhe letra e kartoni.

Plastika perdoret gjeresisht per amballazhimin e ushqimeve te ngrira, artikuj te tjere te fresket ushqimore qe mund te prishen, ushqime te lehta si patate e pretzels, produkte te perpunimit te qumeshtit dhe nje numur I madh ushqimesh me baze buke (bakery items). Ne formen e shisheve plastika perdoret per amballazhimin e pijeve dhe vajit ushqimor. Perdoret gjeresisht per amballazhimin e mishit dhe peshkut te ngrire. Perdorim te gjere ka edhe ne trajte filmi te holle. Avantazhet Plastika ka cmimi te lire, eshte lehtesisht e formueshme, eshte amballashi me i holle qe mund te prodhohet, ka game shume te gjere perdorimi duke filluar nga flete elastike e manovrueshme deri ne shishe me presion, nuk lejon shkembim te ambjentit te materialit te amballazhuar me ambjentin e jashtem, nuk vepron me materialin e amballazhuar, eshte shume mire i riciklueshem, ka karakteristika fiziko kimike shume te mira, etiketohet shume kollaj. Disavantazhet ndotes i ambjentit, nuk shperbehet kollaj, shkalla e riciklimit e ulet, linjate prodhimit jane shume te kushtueshme dhe marrin kuptim vetem per prodhime vertet masive, nuk krijon mbrojtje te mire nen efektin e rezeve ultraviolet.

Alumini eshte shume I pershtatshem per amballazhimin e pijeve te ndryshme si lengjet e frutave, pijet e buta, birre dhe shume ushqime te tjera te konservuara si dhe per prodhime bejkerie. Avantazhet prodhohet lehtesisht, eshte ekologjikisht miqesor, ka game te gjere prodhimi qe nga fletet deri ke shisheet, lehtesisht I riciklueshem, mbron shume mire ndaj rezeve ultraviolet, transmeton shume mire temperaturen, nuk vepron me materialin qe amballazhohet. Disavantazhet eshte amballazhi masiv me i kushtueshem, nuk lejon frymarrjen e materialit te amballazhuar me ambjentin, nuk mund te behet thes ose qese pa u kombinuar me nje material tjetet, kerkon invetsime te medha per prodhimin e produkteve te amballazhit qe vlen vetem per prodhime masive, etiketimi eshte i veshtire zakonisht behet me elemente shtese.